



AKADEMIA E SIGURISE
SENATI

Nr. 5826/Prot.

Tiranë më 25 Mars 2016

2
Nr. 19. Prot

VENDIM Nr. 16

Bazuar në nenin 131 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Urdhrin nr. 110, datë 15.03.2016 të Ministrit të Arsimit dhe Sporteve "Për fillimin e procesit zgjedhor dhe datën e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet e arsimit të lartë" si dhe Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet e arsimit të lartë";

Senati i Akademisë së Sigurisë i mbledhur sot më datën 25.03.2016 mbasi diskutoi në lidhje me këtë process,

VENDOSI:

1. Të njihet i gjithë personeli i Akademisë së Sigurisë me Urdhrin nr. 110, datë 15.03.2016 të Ministrit të Arsimit dhe Sporteve "Për fillimin e procesit zgjedhor dhe datën e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet e arsimit të lartë" dhe Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet e arsimit të lartë".
2. Hapja e procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese të Akademisë së Sigurisë të fillojë nga data 16.03.2016.
3. Data e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese të Akademisë së Sigurisë të jetë data 20.04.2016.
4. Kandidatët për autoritetet drejtuese të të gjitha niveleve, për Senatin Akademik dhe komisionet e përhershme vetëkandidohen.
5. Senati Akademik brenda tre ditëve, me votim të fshehtë të miratojë përbërjen e Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ) dhe sekretarin i cili është pa të drejtë vote. KIZ duhet të jetë i përbërë nga 5 anëtarë nga të cilët 1 (një) të jetë përfaqësues i studentëve.
6. Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ) me shumicë votash në mbledhjen e parë të tij të zgjedhë kryetarin.
7. KIZ të nxjerr udhëzime për organizimin dhe zhvillimin e procesit zgjedhor në të gjitha njësitë e institucionit, dhe të zbatoj të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Neni 6 i

Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet e arsimit të lartë".


8. Komisioni Institucional i Zgjedhjeve të kryejë edhe rolin e KZF, pasi numuri i zgjedhësve në AS është shumë i vogël.
9. Procesi i zgjedhjeve të bëhet për këto funksione:
 - a. Rektor i Akademisë së Sigurisë
 - b. Dekan i Fakultetit të Sigurisë Publike
 - c. Dekan i Fakultetit të Hetimit të Krimeve
 - d. Drejtor i Qendres së Kërkimit Shkencor
 - e. Drejtor i Shkollës Bazë të Policisë
 - f. Përgjegjës Departamenti në çdo fakultet
 - g. Anëtar i Senatit Akademik
 - h. Anëtar të komisioneve të përhershme.
10. Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ) të përcaktoj dhe të afishojë kriteret që duhet të plotësojnë kandidat që aplikojnë për të kandiduar për çdo funksion.
11. Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ) të administroj dokumentacionin e kandidatëve për rektor, drejtor i Qendrës së Kërkimit Shkencor dhe kandidatëve për në Senatin Akademik, dhe pas verifikimit të dokumentacionit të miratoj listën e kandidatëve për rektor dhe kandidatëve për në Senatin Akademik. Pas rregjistrimit, çdo kandidat i i jap vërtetimin e regjistrimit si kandidat.
12. Sektori i Burimeve Njerëzore të përgatitë listën e zgjedhësve me:
 - a. Anëtarët e personelit akademik me kohë të plotë për çdo njësi kryesore dhe njësi bazë;
 - b. Studentët që ndjekin studimet në ciklin e parë të studimeve në Akademinë e Sigurisë.
13. Fushata zgjedhore fillon një ditë pas shpalljes së listës së kandidatëve prej komisioneve zgjedhore që regjistrojnë kandidatët dhe përfundon 24 orë para ditës së zgjedhjeve. Dita para datës së zgjedhjeve dhe data e zgjedhjeve deri në mbylljen e votimit, formojnë periudhën e heshtjes zgjedhore. Në periudhën e heshtjes zgjedhore nuk lejohet asnjë lloj fushate zgjedhore.
14. Gjatë fushatës zgjedhore çdo kandidat ka të drejtën të bëjë propogandë zgjedhore në çdo mënyrë të ligjshme. Fusha zgjedhore duhet të fokusohet kryesisht në paraqitjen përpara personelit akademik dhe studentëve, të:
 - a. programit dhe vizionit të kandidatit për zhvillimin e njësisë ose organit për të cilin konkurron.
 - b. mënyrës se si do të drejtojë dhe administrojë aktivitetin akademik dhe kërkimor-shkencor në njësinë për drejtimin e të cilës kandidon.
15. Dekanët, drejtor i Shkollës Bazë, drejtor i Qendrës për Kërkimin Shkencor, Shefi i Sektorit të Zhvillimit Profesional dhe shefat e Sektorëve/Departamenteve në

Fakultetet t'iu krijojë kushte të përshtatshme dhe të barabarta të gjithë kandidatëve për të zhvilluar aktivitetet e tyre në kuadër të fushatës elektorale. Në përputhje me kërkesën e kandidatit për kohën dhe vendin për zhvillimin e aktivitetit, administrata e institucionit të marr të gjitha masat e nevojshme për zhvillimin e fushatës elektorale, jashtë orëve të mësimit që zhvillohen në Akademinë e Sigurisë.

16. Me këtë Vendim të njihet i gjithë personeli i Akademisë së Sigurisë.

KRYETARI I SENATIT

Bilbil MEMAJ



Tirane, 25 mars 2016